

INFORMACION PER NDERVEPRIMIN ME MJEDISIN

“PULARI” (MBARESHIMI INTESIV I PULAVE)

(Sipas Vendimit nr. 686 datë.29.07.2015)

INVESTITOR: "BESMIR JUSHI"

Adresa: Lagjia Nr.6, Rruga Shen Vlash, Laç

Përgatiti Raportin: Ing. Elvis NDREKA

Ekspert mjedisi

Licence nr.: LN-5945-10-2018

NIPT: L88320501V

GUSHT 2020

PERSHKRIMI I PROJEKTIT

- 1) Pershkrim i mbuleses bimore**
- 2) Informacion per pranine e burime ujore**
- 3) Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative**
- 4) Pershkrim i shkurter per shkarkimet e mundshme ne mjedis**
- 5) Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve**
- 6) Mundesia e rehabilitimit te mjedisit**
- 7) Masat e mundshme per shmangien e ndikimeve negative**
- 8) Ndikimet e mundshme ne mjedis**

Maredhenia mjedis-shendet dhe implikimet e saj

Mjedisi dhe njeriu nderveprojne ne menyre intensive duke shkaktuar efekte te ndersjellta tek njeri-tjetri. Kjo gje vihet re me shume ne ditet e sotme fale zhvillimit industrial, teknologjik, infrastrukturor, urbanizimit masiv, etj. Aktualisht, shumica e vendeve po perballen me nje sere problematikash te reja sociale e mbi te gjitha shendetesore te shkaktuara nga demtimi i mjedisit. Kjo pasi veprimtarite dhe aktivitetet qe njerezit kryejne per te siguruar jetesen e perditeshme ne menyre te pashmangshme ndikojne ne mjedis. Njeriu mund te shkaktoje ndotjen permes prodhimit apo konsumit, kur perdor energji, lende djegese, kur prodhon mbeturina apo keqperdor burimet e tjera natyrore. Aktivitetet ekonomike kane gjithashtu ndikime te konsiderueshme ne mjedis. Ato perdorin energjine per makinerite, lendet djegese per transport, apo lenden e pare per prodhim. Ne perfundim te ciklit prodhues krijohen mbetjet te cilat duhet te perpunohen. Keshtu pra, aktiviteti human pervec se rrit mireqenien tone, sjell efekte te demshme qe nuk mbeten vetem tek mjedisi. Keto efekte reflektohen ne problem shendetesore ne probleme sociale si dhe ne vete cilesine e jetes se njerezve.

1) Pershkrim i mbuleses bimore

Ndryshueshmeria biologjike paraqitet e varfer, flora ne zone eshte me zhvillim te dobet. Territori ne studim karakterizohet nga nje ultesire me nje shtrirje pak a shume horizontale me pjerresi drejt perendimit, me kuota qe levizin ne kufijte 70 – 155m mbi nivelin e detit, te dominuara kryesisht prej rrafshinave te pershkruara nga kuota 150m. Terreni i zones eshte fushor dhe pa pjerresi. Territori ka nje peisazh te thjeshte tipike e nje zone rurale. Zona eshte ne pergjithesi e mbulur nga barishte dhe te mbjellat bujqesore e vet pronareve te tokave. Zona ne vleresim vleresohet si toke e llojit are ku sot nuk eshte e shfrytezuar per qellime bujqesore apo blektorale, eshte nje perfaqe toke me pamje te thjeshte.

Persa i perket vegjetacionit kjo zone eshte e paster pa drure dhe peme te larta, vetem bimesi rreth kanaleve kullues dhe ajo e kulturave te mbjella ne disa parcela te vogla te zones.




2) Informacion per pranine e burime ujore

Rrjeti hidrografik meqe ne kete territor eshte i kufizuar nuk eshte i zhvilluar, pra nuk kemi prani te shume perrejve apo lumejve ne zone. I gjithë terreni ehte i kufizuar nga nje rrjet kanalesh kullimi dhe i bonifikuar. Gjate kryerjes se rikonicioneve dhe vrojtimeve gjeologjike te gjurmes se objektit pjese e analizimit dhe e ketij studimi eshte dhe gjetja e pranise ose mungeses se ujrave nentokesore; niveli i tyre nga siperfaqja e terrenit si dhe karakteristikat e tyre. Ne pergjithesi ne keto terrene nuk ka nje rrjet te zhvilluar grafik i cili ne gjurmen e aktivitetit nuk ka asnje ndikim te drejteperdrejte. Meqenese objekti ndodhet ne terren teresisht fushor rrjeti kryesor hodrografik perfaqesohet nga nje sistem kanalesh kullimi dhe ai i kanalit te ujrave te larta.

Ujrat nentokesore ne kete zone lidhen kryesisht me influencen e rreshjeve atmosferike. Ne pergjithesi keto ujra jane te pastra; pa ngjyre; pa ere ose shije. Si te tilla nuk paraqesin asnje influence apo sjellje agresive karshi aktivitetit qe do te zhvillohet.

Ne zonen e ngushte te projektit verehet se nuk ka burime siperfaqesore dhe perreth saj nuk ka zona te lundrueshme dhe nuk ndodhen lumenj, liqene dhe dete, prandaj gjate shfrytezimit nuk do te cenohen rruget ujore, brigjet lumenjte, dhe bregdetet etj.



Baseni ujr Mat.

Nderthurja e pakove ranore e konglomeratike me ato argjilore i ka dhene mundesi grumbullimit ne sasira te konsiderueshme te ujrave nentokesore (akuiferet e tortonianit, mesinianit dhe kuaternarit). Per kete flasin puset e shumta te hapura kohet e fundit nga vete fermeret dhe puset e thella te hapura nga hidrogeologjia para vitit 1990, qe furnizonin te gjitha qendrat e banuara me uje te pijshem nepermjet ujesjellsave te ndertuara ne vite te ndryshem. Per fat te keq keta ujesjellsa aktualisht nuk funksionojne, prandaj edhe fermeret jane detyruar te hapin vete puse te ceket (deri 10 m) per te siguruar ujin per nevojat e tyre. Kjo pasuri jo e vogel, ne kushtet kur ne siperfaqe, siç theksuam, rezervat ujore jane teper te kufizuara, duhet te vleresohet ne strategjite dhe planet e zhvillimit te qendrueshem te zones.

3) Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative

- ndikimet negative ne karakteristikat fizike te zones se projektit

Siperfaqja ne te cilen do te behet shfrytezimi nuk duket nga qendrat e medha te banuara, me perjashtim te rasteve te kalimtareve qe udhetojne ne rrugen prane.

Duhet theksuar se siperfaqja qe do te shfrytëzohet është pak a shume horizontale me pjerrësi nga veriu, me kuota qe levizin ne kufijte 70-155m mbi nivelin e detit. Aktiviteti “PULARI” prek perkohesisht peizazhin ekzistues dhe topografine e saj per gjate kryerjes se aktivitetit . Me masat qe do merren per rehabilitimin e saj, gjelberimin me bime qe rriten ne zone, gjate ushtrimit te aktivitetit dhe ne mbyllje te aktivitetit, peizazhi dhe topografia e zones do te permiresohet dukshem do te krijohet nje ambjent panoramik i kendshem per syrin e njeriut dhe clodhes. Dëmtimi te vegjetacionit bimor, nuk do te kete pasi vendi ku do te ushtrohet aktiviteti është i zhveshur nga bimësia dhe është toke private. Nga demtimet qe i është ber bimesise vitet e fundit është rritur dukshëm erozioni por dhe është ulur ndjeshëm numri i shpendëve dhe folezimi i tyre, janë çrregulluar agroekosistemet, ndjehet mungesa e rolit të tyre pastrues, shëndetësor etj. Aktiviteti ne fjale do te mbjelli peme ne perimetrin rrethues te prones ne menyre te tille qe te krijohen dhe kushte per folezizim te shpendeve te eger.

Mbareshtimi intesiv i pulave do te behet me nje teknologji modern e cila nuk do te ndikojë fare ne vegjitacionin e zones.

- ndikimet negative ne habitatet dhe biodiversitetin e zones se projektit

Zona ku do te ushtrohet aktiviteti “PULARI” nuk ka bimesi te larte është e mbuluar tek tuk me shkurre dhe ne vende te vecanta është toke djerre. Ne kete zone nga vrojtimi qe kemi bere ne vendin ku do te ushtrohet aktiviteti nuk ka bimesi pervecse barishte.

Nga ky aktivitet nuk demtohet flora dhe fauna e rrezikuar e percaktuar ne VKM nr. 804. dt.

4.12.2003 dhe e listuar ne urdherin e Ministrit nr. 146,dt.8.5.2007 Nga subjekti ne zbatim te projektit do te merren masa qe zona ne fjale te jete gjithmone e kufizuar dhe te rehabilitohet duke u pyllëzuar me peme frutore por edhe decorative qe i rrezistojne klimes se zones.

Zona ne fjale nuk përfaqëson zone me rëndësi të veçantë dhe për këtë arsye nuk është parashikuar sipas Strategjisë për “Ruajtjen e Biodiversitetit dhe Planit të Veprimit si Zonë e Mundëshme” për tu shpallur “Peizazh i mbrojtur”.

- Shkarkimet ne mjedis dhe prodhimi i mbetjeve

Nga procesi i punes ne rruge teknologjike, dalin mbetje te ngurta (dhe pse keto jane ne sasi te vogla) te cilat dalin nga aktiviteti jetesor i punetoreve. Keto mbetje mblidhen nepermjet koshave te vendosur ne ambjentet e punes dhe prej andej shkarkohen ne vendin e depozitimit te mbetjeve

te ngurta te percaktuara nga Pushteti Vendor. Mbetjet qe vijne nga jashtqitjet e shpendeve do te grumbullohen Brenda territorit ku do te ushtrohet aktiviteti dhe do te prdoren per pleherimin e tokes bujqesore. Kurse ne raste se do te kete shpende te ngordhur per shkaqe te ndryshme ato do te largohen nga subjekte te licensuara per asgjesimin e tyre.

- ndikimet negative shtese (kumulative) ne cilesine e mjedisit ne zonen e projektit

Gjate fazes normale te operimit te projektit nuk do te kete emetime te gazeve, lengjeve, mbetjeve toksike, helme te ndryshme dhe substanca te tjera te demshme, te cilat mund te ndikojne negativisht ne shendetin e punonjesve, banoreve dhe mjedisin perreth, floren dhe faunen e zones, burimet ujore. Mbareshtimi intesiv i pulave pra “Pularia” eshte nje proces i thjeshte pune. Meqenese nuk do te perdoren ne procesin e punes lende te demshme, nuk do te kete shkarkime te lendeve kimike te demshme per mjedisin ne ajer, toke dhe uje. Siperfaqja dhe godina qe do t’i nenshtrohet procesit te punes nga subjekti Besmir Jushi eshte prone e perbashket e familjes dhe e eshte me document pronesie.

- ndikimet sociale te projektit te tilla si ndryshimi i perdorimit te tokes dhe shqetesimet qe mund te lindin nga ndikimet ne mjedis te projektit (si zhurmat, pluhuri, perdorimi i burimeve natyrore etj).

Ky aktivitet do te kryet larg zonave te banuara, ne nje siperfaqe te sheshte. Zbatimi projektit nuk kerkon ndryshime ne popullsi, spostime te zonave te banuara ose krijimin e zonave te reja banimi,etj. Aktiviteti i mbareshtimit intesiv te pulave do te behet ne nje zone te kufizuar ne krahasim me siperfaqen dhe popullsine e rajonit.

4) Pershkrim i shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis

Shtrirja fizike dhe kohezgjatja e ndikimeve te identifikuara

a.Shtrirja fizike- Vlereson siperfaqen apo dimesionin hapsinore te nje ndikimi te dhene ne raport me burimin qe gjeneron ate ndikim, p.sh. ndikimi ne toke nga shfrytezimi eshte nje ndikim saktesisht i percaktuar i cili mund te matet, por ne se do te kete erozion te tokes ndikimi rritet ne permasa fizike te siperfaqes se marre per studim.

b. Kohezgjatja e ndikimit – Vlereson se sa do te zgjase nje ndikim i caktuar ne dimesionin kohe (ndikim i perhershem apo i perkoshem). Ndersa te gjitha ndikimet e tjera negative ne mjedis jane te perkoshme, si shkarkimet e ujit te rreshjeve, gjelberimit, etj

c.Kthyeshmëria –Vlereson mundësin e kthimit të mjedisit të ndikuar në gjendjen e tij të me pareshmë (aftësia për tu rehabilituar dhe regjeneruar).

d.Rëndësia – Realizon një vlerësim total të tre përmasave të mesipërme dhe njekohësisht thekson vëmendjen që duhet patur për administrimin e ndikimit.

Ndikimet e parashikuara nuk kanë shtrirje të madhe fizike, aktiviteti ndodhet në distancë të konsiderueshme nga zona me e afërt e banuar dhe nuk preket nga zhvillimi i këtij aktiviteti. Zhurmat që krijohen në këto aktivitet janë në nivele të moderuara të cilat nuk kanë asnjë ndikim negativ. Analiza e frekuencës së zhurmës të emetuar nga këto makineri dhe pajisje tregon se ato ndodhen në mesataren e frekuencës 100 – 150 Hz, e cila është e pranueshme nga veshi i njeriut.

5) Informacion për kohezgjatjen e mundshme të ndikimeve

Ndikimet e mundshme në këto aktivitet do të jenë për aq kohë sa do të vazhdojë të ekzistoj edhe aktiviteti në fjalë.

6) Mundësia e rehabilitimit të mjedisit

Plani i emergjencës dhe rehabilitimit

Si çdo veprimtari që kryhet nga njeriu, është e pamundur të shmangim incidentet e ndryshme të cilat mund të shkaktohen nga faktore natyrore, ekologjike. Industrial, social, etj. Të cilat sjellin dëm të menjehershëm e të rëndë për jetën, për shëndetin e popullatës dhe gjëse të gjalla, për pasuritë, për trashgimin kulturorë dhe për mjedisin. Në këto kuader duke marrë në konsideratë peripilimin e një plani mbi “Emergjencën dhe Rehabilitimin”.

Emergjencat në këto objekt mund të vijne nga:

- a) **Renia e zjarrit.** Në rastet e rënies së zjarrit, në territorin e subjektit në fjalë do të jetë e afishuar skema e lajmërimit. Mbi bazën e kësaj skeme, personeli që ndodhet në objekt vepron duke bërë njoftimin e PMNZSH me numrat e zjarrefikseve të afishuara në tabelat perkatese. Brenda objektit do të funksionojë edhe lidhja telefonike, telefonat celularë që do të vihen në dispozicion për lajmërimin e zjarrefiksve. Personeli present bazuar në skemën teknologjike të rendisin në objekt, vepron menjëher me fikset e dorës dhe tenton të kufizojë përhapjen e metejshme të zjarrit, kjo edhe nëpërmjet hidranteve të ujit present në objekt.
- b) **Renia në tension.** Duke u nisur nga specifika që kanë makinerit dhe pajisjet elektrike, është marrë në konsideratë edhe mbrojtja nga renia në tension e paisjeve dhe personelit.

Lihet per detyre qe drejtuesi i aktevitetit te percaktoj dhe ndjek veprimet e menjehershme ne raste te tilla, sado qe ato nuk mendohet qe te jene prezente ne kete aktivitet.

- c) **Shkarkimet atmosferike.** Edhe shkarkimet atmosferike jane nje potencial i renies se zjarrit ne objekt apo demtim te jetes se njerezve. Sipas investitorit, te gjitha objektet me lartesi ne piken me te larte, si shtylla ndricimi dhe shtyllat e furnizimit me energji elektrike ajrore jane te perfshira ne sistemin e mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike.
- d) **Nga permbytjet.** Objekti eshte i rrethuar edhe ne rast permbytjesh te medha, jane mundesite e hapjes ne disa drejtime te avllis per te qarkulluar uji i tepert.

Duke u bazuar ne Ligjin “Per emergjencen civile” subjektit i del si detyre:

1. Te organizoje grupin permanent te punes per emergjencen te drejtuar nga investitori I aktivitetit.
2. Te organizohet trajtimi i punonjesve mbi detyrat e secilit sipas vendit te punes dhe te gjithë grupit te interest.
3. Te organizojne ne rast nevojë evakuimin e punonjesve dhe te vere ne veprim situaten emergjente.
4. Te organizohet dhenia e ndihmes se shpejt ne rast te nje emergjence apo te aksidenteve ne pune.
5. Te merrin masa per lirshmerine e rrugeve te kalimit ne lidhje me sherbimin e mbrojtjes nga zjarri per ardhjen e zjarrefikesve.
6. Te mbahen ne gadishmeri te vazhdueshme kutia e ndihmes se shpejte dhe mjeteve zjarrefikese.
7. Ne rast te ndodhjes se ndonje ngjarje me deme te cdo dimensionit te hartohet plan masash per rehabilitimin e tij duke vendosur edhe afate.
8. Ne rast se aktiviteti do te mbyllet te merrin masa per mirembajtjen e tij, si dhe te percaktohet plani i rehabilitimit te territorit.

7) Masat e mundshme per shmangien e ndikimeve negative

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne marrjen e masave per uljen e ndotjeve gjate zhvillimit te aktivitetit, ne ajer, te pluhurave dhe zhurmave, si dhe uljen e efekteve negative hapsinore te territorit, faunen dhe floren. Por pikesynimi i studimit mbetet rehabilitimi i tokes dhe evitimi ne maksimum i erozionit.

Identifikimi i masave per te eleminuar apo zbutur ndikimet negative ne mjedis

Masat qe duhen konsideruar per ndikimin ne mjedis jane:

1. Duhet te tregohet kujdes ne respektimin rigoroz te kushteve teknike ne objekt per te reduktuar mundesite e renies se zjarrit dhe avarite ne system duke shmangur ndotjen ne mjedis. Te behet sipas grafikut vaksinimi i rregullt i shpendeve.
2. Parandalimi i shkarkimeve te mbetjeve ne mjedisin e zones.

3. Lidhur me mbetjet e grumbulluara te menaxhohen ne bashkpunim me subjekte te licensuara ose me subjektin e grumbullimit te mbetjeve.
4. Te krijohen kushte optimale te jeteses per te mos patur humbje te marshimit te pulave.
5. Punojesit te jene te trajnuar paraprakisht dhe te jene vazhdimisht ne mbikqyrjen e drejtuesit teknik gjate proceseve te punes.
6. Mbjellja ne territory ka koeficient mbi optimalen i lihet detyre te vazhdoje te rritet, me brez tjetër pemesh te larta pergjate murit rrethues te prones, ne menyre qe te reduktoje impaktin ne peizazh.
7. Te vazhdohet te kryhet menaxhimi i integruar i mbetjeve te extremeve te shpendeve, ne menyre qe te mos jene nje problem mjedisor i zones dhe mjedisit uxor.

8) Ndikimet e mundshme ne mjedisin nderkufitar

Objekti eshte ne brendesi te territorit te vendit dhe nuk ka ndikime nderkufitare.